



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 111, Datë 21.04.2026

MBI

**MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13 dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 879/7 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k.

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.
- Shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për modifikimin e licencës, duke ndryshuar në Aneksin A të saj numrin e njëjësive gjeneruese (panele) dhe vendosjen në të, të pajisjeve të depozitimit të energjisë, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të licencës prej 50 MW.
- Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 78, datë 14.02.2023 dhe Kontratës me nr. 1200 rep, nr. 485 kol., datë 03.03.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) shoqëria është pajisur me të drejtën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 50 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt konçesioni, në zonën kadastrale nr. 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, nga shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 74, datë 12.03.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.03.2026 dhe 14.03.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 14.04.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 879/2 prot., datë 18.03.2026, ka njoftuar MIE-n, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” OST sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur kthim përgjigjeje.
- Me shkresën nr. 879/3 prot., datë 18.03.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 879/4 prot., datë 27.03.2026, dhe shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879/5 prot., datë 31.03.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e munguar.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmeve a, b, c, d, e, f dhe g, si dhe ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 50 MW, duke ndryshuar numrin e paneleve dhe duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI